

FORMULARI 3 – TEKSTI I THIRRJES PUBLIKE



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
 KOMUNA E GJILANIT
 OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI



Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport / Direkcija za Kultururu, Omladinu i Sport / Department of Culture, Youth and Sport

REFERENC-Ë:			
CC:			
PËRMES/PREKO/THROUGH:		Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	
NGA/OD/FROM:		DKRS - Gjiilan	
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:		Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare për organizimin e manifestimit kulturor “Flaka e Janarit 2022”	
Nr. i Zyrës:		Lokacioni:	Gjiilan
Br. Kancelarije:		Lokacija:	
Room No:		Extencion:	
		Data:	12.11.2021
		Datum:	
		Date:	

Gjiilan, 12.11.2021

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e organizimin e manifestimit kulturor “Flaka e Janarit 2022” të OJQ-ve.

1. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e {Kulturës;} të aplikojnë për mbështetje financiare për projektin e shtyllave kryesore të Manifestimit mbarëkombëtar “Flaka e Janarit 2022”.

2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre për organizimin, konceptimin dhe realizimin e fushave/shtyllave kryesore të manifestimit, si në vijim:

- Akademitë (Akademia e Flakës dhe Akademia Përkujtimore për Presidentin Dr. Ibrahim Rugova)
- Arti dramatik -“Talia e Flakës” - Festivali i Dramës Shqipe
- Arti pamor - Peneli i Flakës – Ekspozita Kolektive a Artit Pamor
- Arti letrar - Pena e Flakës – Ora e madhe letrare
- Arti muzikor - Fest Flaka – Festival i muzikës popullore
- Xixat e Flakës – Festival i këngës për fëmijë
- Skenografia, koncepti ideor dhe vizual i të gjitha skenografive dhe realizimi i të gjitha punëve teknike të të gjitha shtyllave sipas specifikave.

Kriteret:

- Projektet e propozuara duhet tu përmbahen datave të implemimentimit të aktiviteteve sipas programit të manifestimit “Flaka e Janarit 2022” nga data 11.01.2022 deri më 31.01.2022;
- Projektet duhet përmbajnë projektin ideor të konceptuar me shtjellimin e idesë dhe planin për realizim;
- Specifikacionet financiare të detajuara;
- Të ofrojnë ide kreative dhe të jenë të pa publikuara më parë.
- Të ofrojnë projekte të specifikuara dhe përshkrimin e përgjithshëm të projektit.
- Të ofrojë dëshmi për përvojat e më hershme në teatër, skenografi, muzikë, letërsi, arte pamore.

3. Afati për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë kalendarike dhe përfundon me datën 26.11.2021, ora 16:00.

4. OJQ-të mund të aplikojnë në projekte/ propozime të realizimit të shtyllave të manifestimit në kuadër të kësaj thirrjeje. Periudha e zbatimit të projektit është data 11.01.2022 – 31.01.2022. E njëjta OJQ mund të jetë partnere në disa projekte në fushat prioritete të thirrjes. Të drejtë aplikimi me projektet e tyre OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo- Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës së paku *një vit* para datës së publikimit të thirrjes publike. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e {Kulturës}. OJQ-të duhet poashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale *ndaj ofruesit të mbështetjes financiare* dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Pikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të *ofruesit të mbështetjes financiare* (kk.rks-gov.net/gjilan).

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme: *Qendrën për Shërbim të Qytetarëve, ish-Bankosi Nr.1, Komuna e Gjilanit, me tekstin: FLAKA E JANARIT 2022 – THIRRJA PUBLIKE NGA DKRS*

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

5. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen përmes zyres së DKRS-së.

Lista e dokumenteve të thirrjes publike

Për OJQ-të:

- Çertifikata e regjistrimit të OJQ-së;
- Çertifikata e nr. fiskal;

- Vërtetimi/Konfirmimi i llogarisë bankare të OJQ-së (nuk pranohet kopje e kartelës bankare);
- Kopjen e letërnjoftimit / pasaportës të përfaqësuesit të OJQ-së